

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ALBANIA RENTAL VEHICLE” SH.P.K**

Sot në datë 11.11.2020, duke u bazuar në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, Ortaku i vetëm me vullnetin e tij të lirë :

- **Z. Mino Xhafa** , i biri i Shpëtim , lindur më 11.03.1988, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i Id me numer 035935413 dhe nr.personal I80311056C.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

**Neni 1 – Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është **“ALBANIA RENTAL VEHICLE” SH.P.K**

**Neni 2 – Selia**

Selia e shoqërisë është në adresën Kashar, Njësia Administrative nr.13, Rruga Teodor Keko, Pallatet Romario, Kati 1.

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

Dhënie me qira të automjeteve, shitje-blerje dhe import-eksport.

**Neni 5 – Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga **Z Mino Xhafa**, ne vleren 100.000 (njëqind mije) leke, perkatesisht 100% (njëqind) përqind të kapitalit të shoqërisë. Shoqëria

mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Ortakut te vetem .

- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë e barabartë, me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë.

#### **Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - Shitblerjes;
  - Trashëgimisë;
  - Dhurimit
  - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Ortakut te vetem.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim;

#### **Neni 7- Administratorët**

Me këtë Akt emërohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. Mino Xhafa** , i biri i Shpëtim , lindur më 11.03.1988, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i Id me numer 035935413 dhe nr.personal I80311056C.

#### **Neni 8 – Legjislacioni**

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 9 – Gjuha**

Ky Akt Themelimi është i përbërë në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

**“ALBANIA RENTAL VEHICLE” SH.P.K**

**Z.Mino Xhafa**

*MINO XHAFJA*